



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 3, datë 31.01.2022

Mbi rinovimin për një periudhë një vjeçare të kontratave me bankat agjente të përzgjedhura në listën paraprake për vitin 2022

Në bazë dhe për zbatim të nenit 42, pika 7 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 25, pika 2, pika 4 dhe pika 5 të Rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruara”, të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 3762, datë 18.07.2016, si dhe vendimit të Këshillit Drejtues nr. 39, datë 15.12.2020 “Mbi përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake për periudhën 2021-2023”, me propozim të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Të rinovojë për një periudhë 1 (një) vjeçare kontratat me bankat agjente të përzgjedhura në listën paraprake për vitin 2022, si vijon:
 - Banka Kombëtare Tregtare SHA;
 - Banka Credins SHA;
 - Banka Intesa SanPaolo SHA.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë bankat e përzgjedhura në listën paraprake, si dhe Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.
3. Ngarkohet Sektori për Marrëdhëniet me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tianda Kaçi
Sekretare

Donald Duraj
Kryetar